



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3543/2 Prot

Shkodër, më 02.03.2021

Lënda: Kthim përgjigje ankesës tuaj nr. 3543 prot., datë 01.03.2021

Bashkia Shkodër ju falenderon për interesimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në procedurat e shitjes me ankand të Aksioneve të Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" SH.A. në masën 100% dhe inkurajon çdo subjekt që të marrë pjesë.

Me datën 1 Mars 2021 jemi informuar në lidhje me formularin e ankesës së depozituar pranë Bashkisë Shkodër, administruar me nr. 3543 prot., datë 01.03.2021, ku keni paraqitur formularin e ankesës si palë e interesuar për ankandin me objekt: "Shitje me ankand të aksioneve të klubit të futbollit "Vllaznia" sh.a. në masën 100%", i cili zhvillohet me datë 09.03.2021, ora 10.00.

Përsa mësipër sipas Vendimit nr 79 date 01.03.2021 bazuar në germën ç) pika 8, Kreu VIII i VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 "Per miratimin e rregullave të ankandit publik", ndryshuar me VKM nr.33 datë 19.1.2011, VKM nr.692, date 18.10.2011, VKM nr.308 date 10.4.2013, është vendosur **pezullimi i vazhdimit të procedurës, derisa ankesa është shqyrtuar plotësisht.** Me datën 2 Mars 2021, sipas pikes 4 të nenit 42 të ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 "Per Ankandin Publik" Autoriteti shitës Bashkia Shkodër ka marrë në shqyrtim ankesën e subjektit të interesuar.

A. Përsa mësipër referuar procedurave të zhvilluara konstatojmë se Ankimuesi ka drejtuar kundërshtimin ndaj "**Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi**":

1.NDAJ PERSONAVE QE KANE HARTUAR DOKUMENTAT E ANKANDIT (KRITERET për PJESEMMARJE DHE KUALIFIKIM)

B. Duke përcaktuar si natyrë të masës së kërkuar korrigjuese:

1. PEZULLIMIN E PROCEDURES SE ANKANDIT
2. PRANIMIN E KERKESES SE PARAQITUR NGA SUBJEKTI ""COLOSSEO CONSTRUCTION" sh.p.k.
3. NDRVSHIMIN E DOKUMENTAVE TË ANKANDIT SIPAS KONSTATIMEVE TONA

C. Duke parashtruar këto pretendime:

- 1) Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj, konstatojmë së janë vendosur kritere për kualifikim që janë të paqarta dhe njëkohësisht në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi. Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar qartë se: "Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Shkodër në Shoqërinë Klubi i Futbollit "Vllaznia", të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedure e

Hapur Standart e Ankandit, sipas dokumentave standarte tip të ankandit, bashkangjitur këtij vendimi.

Duke iu referuar kësaj vendimarrje, e cila ka karakter detyrues për Bashkinë Shkodër, rezulton se Këshilli i Bashkisë e ka përcaktuar qartë procedurën që duhet të ndiqet për shitjen e aksioneve të Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" por nga ana tjetër ka përcaktuar qarte edhe kriteret që duhet të vendosen paraprakisht për çdo subjekt të interesuar për blerjen e këtyre aksioneve. Në referim të kësaj vendimarrje dhe në referim të përcaktimeve ligjore për ankandin publik, procedurën e hapur të zhvillimit të tij rezulton që Bashkia Shkodër ka vendosur kritere në kundërshtim me ligjin, diskriminuese dhe njëkohsisht për të favorizuar eventualisht ndonjë subjekt të interesuar.

- 2) Në ankim thuhet se: ***"Në kohë që Bashkia Shkodër vendos kritere ekstremisht të ekzagjeruara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore duke mos pasur asnjë arsye logjike dhe ligjore për vendosjen e tyre."***

Si pasojë e kriterëve të vendosur nga ana juaj, ajo që konstatohet menjëherë është shkelja e nenit 1/c për nxitjen e konkurrencës nëpërmjet subjekteve të interesuara, pasi po të ishte bërë një verifikim paraprak në organet tatimore se cilat janë dhe sa është numri i bizneseve që kanë realizuar sponsorizime (përjashtoj ato që janë ortak ose të angazhuar në një ekip tjetër të futbollit shqiptar) është shumë i vogël për të mos thënë nuk ekziston fare.

Vendosja e këtyre kriterëve nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë, pasi favorizon në mënyrë direkte subjektet e preferuar nga ana juaj.

- 3) Në pike të kërkesës për kualifikim është kërkuar që subjekti pjesëmarrës duhet të ketë kontrata, transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo sporteve të tjera të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë e veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB. Nëse është përcaktuar shprehja "Minimalisht", normalisht që të sqarohet edhe e kundërta e saj. Po "maksimalisht" deri kur është e lejueshme dhe e pranueshme për ju që të ekzistojë një eksperiencë e ngjashme. Pasi në interpretimin lateral të fjalës "Minimalisht", i bie që të mos ketë ndonjë kufizim për periudhën se kur duhet të jetë realizuar eksperiencë e ngjashme.

Po ashtu është lenë në mënyrë evasive "përcaktimi i sporteve të ngjashme" duke mos sqaruar se cilin prej sporteve do të vlerësoj si të ngjashëm Bashkia Shkodër, apo thjeshtë do e bëjë vlerësimin vetëm mbi baza subjektive duke favorizuar subjektin e saj preferencial.

- 4) Është kërkuar që të paraqiten dokumentacione sponsorizimi në përputhje me legjislacionin tatimor, ndërkohë që lezgjislacionin tatimor e kushtëzon ruajtjen e dokumentave kontabel tatimor për një periudhë 5-vjeçare. Duke sjellur përjashtimin automatik të subjekteve që kanë kryer sponsorizime në periudha më të largëta se 5 vite.
- 5) Përpilimi i dokumentave është bërë në mënyrë tendencioze duke të lënë përshtypje sikur janë vendosur në dëm të ndonjë subjekti dhe jo në dobi të subjekteve të interesuara.
- 6) Nuk është dhënë as ndonjë sqarim në lidhje me faktin se dare dote behet me detyrimet eventuale që mund të ketë SHOQERIA KLUBI I FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. në mënyrë që të mos ketë pengesa dhe paqartësi në nënshkrimin e kontratës mes fituesit të ankandit dhe Bashkisë Shkodër.
- 7) Në kushtet kur dokumentat e ankandit janë vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore, në kushtet kur nga ana juaj janë bërë shkelje flagrante të ligjit kërkojmë nga ana juaj që të bëni ndryshimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën e ankandit për objektin "BASHKIA SHKODER SHET ME ANKAND AKSIONET E KLUBIT TË FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A. në MASEN 100%", dhe të vendoset kriteret vetëm në përputhje me ligjin dhe vkm që rregullon aktivitetin e ankandëve publike.

D. Persa mësipër Autoriteti Shitës, Bashkia Shkoder parashtron këto fakte:

1. Aspekti procedural në kete ankim:

- 1.1 Procedura e nisur që në Janar të vitit 2017 me hapin e parë vleresimin e aseteve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a i është nënshtruar një procesi të gjerë transparent
- 1.2 Raporti i vleresimit të aseteve të shoqërisë datë 08.06.2018 është publikuar në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër dhe i bërë publik në mjetet e MassMedias dhe prezantuar gjerësisht edhe nga Televizionet lokale [raport vlersimi vllaznia 1640.pdf \(bashkiashkoder.gov.al\)](#)
- 1.3 I gjithë procesi për shitjen e aksioneve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia i është nënshtruar një procedure të gjere për konsultimin dhe këshillimin me publikun në perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” e publikuar gjerësisht dhe në çdo hap në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër [Ecuria e procedurës për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masën 100% \(bashkiashkoder.gov.al\)](#)
- 1.4 Vendimi nr.54 i Keshillit Bashkiak Shkoder, datë 27.11.2020, për dhenien e pëlqimit për shitjen e aksioneve të shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia dhe dokumentave standarte të akandit është bërë në mënyrë të hapur dhe publike duke publikuar vendimin dhe të gjitha dokumentat përkatëse.
- 1.5 Po ashtu hapja e procedurës për dorëzimin e ofertave është bërë nga Bashkia Shkodër nepërmjet njoftimit, publikimit në buletin e njoftimeve publike nr.21 datë 15.02.2021 për objektin "Bashkia Shkodër shet me ankand aksionet e Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a në masen 100 %”
- 1.6 Pra të gjitha procedurat nga fillimi dhe deri në momentin e deritanishem në lidhje me ankandin për shitjen e aksioneve të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a janë zhvilluar në perputhje të plotë me parimin e transparencës të percaktuar në germën b), neni 2 i ligjit Nr.9874, datë 14.2.2008 “Per Ankandin publik”, neni 5 të ligjit Nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe ligjin Nr. 119/2014 “Per të drejtën e informimit”.
- 1.7 Persa mësipër çdo subjekt i interesuar ka patur të gjithë kohën e mjaftueshme për të dhënë mendimet në lidhje me procedurat, në lidhje me kriteret e vleresimit si dhe për të kërkuar çdo informacion tjetër të nevojshem.

2.Persa i takon permbajtjes se ankimit:

2.1 Persa takon kundërshtimeve të ankuesit të pershkruar me siper në germen C1, Ju sqarojm se:

Kriteret e veçanta për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit shitës për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës. Sipas specifikave që ka ky Ankand dhe aktivitetit të shoqërisë tregtare “Klubi i Futbollit Vllaznia” sha ku që nga krijimi i saj dhe deri më tani ka patur problematika të shumta me përmbushjen e objektivave financiare dhe sportive, autoriteti shitës Bashkia Shkoder ka percaktuar kërkesat të veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga subjektet e interesuara në procedurat e ankandit, në mënyrë që të garantohet vazhdimësia, eficaensa dhe përmbushja e objektivave financiare dhe sportive të Klubit të Futbollit Vllaznia sh.a

Në rastin konkret, autoriteti shitës kërkon të krijojë panoramën mbi përvojën e mëparshme të kandidatëve blerës, në mënyrë që të krijojë bindjen se këta të fundit posedojnë eksperiencën e

duhur për të përmbushur me sukses kontratën objekt ankandi, kanë mjetet e nevojshme financiare, kapacitetet njerezore si dhe eksperiencën e duhur në menaxhimin e aktiviteve sportive.

Vlen të theksohet se ligji i posacëm për ankandet publike nuk parashikon asnjë dispozitë me anë të së cilës kufizon autoritet shitëse të përcaktojnë kriteret e vecanta të kualifikimit, që gjykojnë se janë të nevojshme për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së kandidatit për përmbushje me sukses të kontratës, për sa kohë këto kriteret nuk tejkalojnë objektin dhe volumin e saj, praktikë kjo e konsoliduar edhe nëpërmjet Vendimeve të Komisionerit të Prokurimeve Publike.

Këshilli Bashkiak në zbatimin të detyrave dhe kompetencave të tij, neni 54. germa e) e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Me vendim nr.54, datë 27.11.2020 “Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të Futbollit “Vllaznia” SH.A. në masën 100%”, Këshilli Bashkiak ka vendosur:

- *Miratimin për shpalljen për shitje të 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotoren si aksionere e vetme në shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia”*
- *Çmimi minimal i shitjes së 100% të kuotave është 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) lekë*
- *Forma e shitjes së aksioneve që zotërohet nga Bashkia Shkodër në Shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia”, të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur Standart e Ankandit, sipas dokumentave standarte tip të ankandit, bashkëngjitur këtij vendimi:*

Autoriteti shitës është bazuar në VKB nr.54, datë 27.11.2020, dhe ka hartuar dokumentacionin sipas standartit tip, të miratuar.

VKM me Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar. Kreu V, Zhvillimi i procedurave, pika 5.1 Hartimi i dokumentave të ankandit, përcakton se:

- a) Njësia e ankandit është përgjegjëse për hartimin e dokumentave të ankandit, në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Njësia është plotësisht përgjegjëse për hartimin e dokumentave të ankandit, kërkesat për kualifikim dhe kriteret të vlerësimit”*

Kriteret e vendosura nga njësia e ankandit, e ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Autoriteti Shitës, Bashkia Shkodër ka parashikuar kriteret të cilat janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për ankandin publik, në fushën e sportit, me ligjin e procedurave tatimore si dhe për sponsorizimet.

Prandaj sa më sipër kundërshtimi konsiderohet në interpretim të gabuar të ligjit dhe nuk duhet pranuar

2.2 Përsa takon kundërshtimeve të ankuesit të pershkruar më sipër në germen C2, Ju sqarojm se:

Autoriteti shitës nuk mund të zhvillojë investigime (verifikime paraprake) përpara zhvillimit të nje procedure ankandi, pasi atëherë do të krijoheshin rrethana të arsyeshme për shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë të pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik. Siç edhe mund të jeni në dijeni sipas ligjit janë zhvilluar konsultime dhe Bashkia Shkodër, si autoriteti më pranë qytetarëve duke u nisur nga interesi më i lartë i tyre, ka përfshirë disa nga sugjerimet e dhëna gjatë këtij procesi duke ezauruar të gjitha përpjekjet, që në këtë garë të ofrohen subjektet të cilat plotesojne ato kriteret të cilat autoriteti shitës Bashkia Shkodër beson se

garantojnë qëndrueshmërinë e shoqërisë tregtare “Klubi i Futbollit Vllaznia” sh.a si dhe përmbushjen e objektivave financiare dhe sportive.

Prandaj sa më sipër kundërshtimi konsiderohet i pambështëtur në ligj dhe nuk duhet pranuar

2.3 Persa takon kërkesës për sqarime të ankuesit të pershkruar më sipër në germën C3, Ju sqarojmë se:

Autoriteti shitës ka përcaktuar si periudhë minimale periudhën e fundit tre vjecare për të krijuar bindjen e tij që subjektet tregtare kanë eksperiencë në menaxhimin e aktiviteteve sportive në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Sigurisht që subjektet të cilat këto eksperiencë i kanë të konsoliduara edhe nga vitet e mëparshme janë më të avantazhuar në ofertat e tyre.

Në Kriteret e Veçanta të kualifikimit është përcaktuar kriteri:

q) Kontrata, transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe për sporte të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

Shprehja “minimalisht në tre vitet e fundit”, nuk përjashton, por lejon pjesëmarrjen e të gjithë kandidatëve të cilët kanë realizuar sponsorizime në një periudhë edhe më të hershme se 3 vitet e fundit, dmth në një periudhë të pakufizuar në afat.

Persa i takon komentit në lidhje me “sporte të ngjashme” ju sqarojmë se nga konsultimet e bera prioritet ka qenë që subjektet që do të paraqesin ofertat e tyre duhet që të pranohen edhe ato që kanë kontribuar në sportet ekipore më të përhapura në qytetin e Shkodrës dhe më gjerë. Kjo perkon pikërisht me zbatimin e parimit barazisë dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë ato të cilët kanë kontribuar në drejtim të financimit-sponsorizimit, bashkëpunimit ose menaxhimit të klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit, apo edhe për sportet e tjera të ngjashme ekipore.

Në Kriteret e Veçanta të kualifikimit është përcaktuar kriteri:

q) Kontrata, transaksione dhe eksperiencë në bashkëpunimin, financimin ose menaxhimin e klubeve sportive, shoqërive sportive të futbollit apo edhe për sporte të ngjashme, minimalisht në tre vitet e fundit, pjesë të veprimtarisë të subjektit të publikuar në QKB.

u) Sponsorizime të ngjashme në një vlerë prej 20,317,600 lekë (40% e vlerës fillestare të ankandit), të realizuara. Çdo sponsorizim rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi, në para a në natyrë, dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme subjekti/tet të paraqesë dokumenta që vertetojnë:

Sponsorizimet në favor të sporteve ekipore më të përhapura, të destinuara për:

- i. evidentimin e talenteve dhe zhvillimin e sportistëve të rinj;*
- ii. mbulimin e shpenzimeve të stafit sportiv;*
- iii. përmirësimin dhe rinovimin e pasurive të luajtshme që i shërbejnë për aktivitetin sportiv;*

- iv. zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive;
- v. shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimin; ose
- vi. mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive.

Në kuptimin e mësipërm, në sportet e ngjashme, përfshihen të gjitha sportet ekipore më të përhapura.

2.4 Përsa takon kundërshtimeve të pershkrjuara në gërmën C4, Ju sqarojm se:

Sipas pikës 2, të nenit 4 të ligjit Nr. 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” në veprimtarinë e tyre organet e njësisve të vetqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Prandaj edhe në kete procedure të ankandit të gjitha subjektet e interesuara jane të detyruara qe kriteret e percaktuara t’i permbushin konform legjislacionit në fuqi. Sipas pikes 2, të nenit 48 të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “**Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**” i ndryshuar është percaktuar që të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, **për të paktën 5 vjet**, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet.

Pra afati minimal i ruajtjes së këtyre dokumentave nuk e përjashton detyrimisht që subjektet të ruajne dokumentacionin e tyre financiar dhe kontabël të plotë apo edhe pjesërisht edhe për nje kohëzgjatje më të madhe.

Mungesa e provave të mjaftueshme konform kuadrit ligjor për të permbushur kriterin e percaktuar për të cilën drejtohet ankimi nuk mund të jetë kusht i arsyeshëm që të detyrojë autoritetin publik të pranojë ekzistencen e fakteve të cilat nuk janë konform kuadrit ligjor.

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit është percaktuar që:

Dokumentat që vërtetojnë transferimin e shumës së sponsorizimit, do të jenë, aktmarrëveshje, vendime të këshillit bashkiak për donacione apo sponsorizime, dokumente bankare që vërtetojnë transferimin e shumave, fatura tatimore, akte dhurimi, proces verbale marrje në dorëzim, fletë hyrje, etj dokumenta që parashikohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë tatimor kontabël e bankar në fuqi.

Neni 48 i Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon që: “*Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet*”, duke mos kufizuar afatin maksimal të ruajtjes.

Informacioni në lidhje me sponsorizimet e bëra duhet të jetë i pasqyruar ligjërisht në Pasqyrat Financiare të këtyre viteve, pasqyra të cilat janë të depozituara në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe në QKB.

Bashkia Shkodër, përveç dokumentacionit tatimor kontabël, ka parashikuar edhe paraqitjen e dokumentave të tjera që vërtetojnë transferimin e shumave të sponsorizimit, si aktmarrëveshje, vendime të këshillit bashkiak për donacione apo sponsorizime, dokumente bankare që vërtetojnë transferimin e shumave, akte dhurimi, procesverbale marrje në dorëzim, etj. të cituara në sqarimin e kriterit.

Prandaj sa mësipër kundërshtimi konsiderohet i pambështëtur në ligj dhe nuk mund të pranohet!

2.5 Përsa takon konkluzioneve të pershkrjuara në gërmën C5, Ju sqarojm se:

Ne të gjithë kundershtimet e paraqitura nuk arrijmë të gjejmë asnjë argument bindës që provon shkeljen e një ligji të caktuar, favorizimin e një subjekti të caktuar apo pikat për të cilat kriteret janë diskriminuese.

Detyrimi për të zbatuar legjislacionin në fuqi është i njëjtë për të gjitha entet publike dhe private në Shqipëri

Detyrimi për të garantuar cilesine me të larte dhe për të kerkuar eksperiencia të konsoliduara mbetet një e drejtë e patjetersueshme e autoritetit shites për të kerkuar nëpërmjet kësaj procedure subjektet të cilat krijojnë besueshmërinë dhe bindjen e duhur dhe në mënyrë absolute nuk mund të cilesohet si diçka e individualizuar vetem tek një subjekt i interesuar!

Prandaj sa mesiper procesi nuk duhet të paragjykohet por duhet të shihet vetem në kendveshtrimin e permbushjes se atyre kriterëve të cilat bazohen në ligj!

2.6 Persa takon konkluzioneve të përshkruara në germen C6, Ju sqarojmë se:

Detyrimet ndaj të treteve të shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” Sha i përkasin të drejtave dhe detyrimeve që ky subjekt duhet që të permbushë në raport me të tretet

Autoriteti Shitës, në DSA, ka pasqyruar linkun me të dhënat e pasqyrave financiare dhe raportet përkatëse të auditimit në faqen ëeb www.bashkiashkoder.gov.al ku mund të informoheni në lidhje me gjendjen financiare të shoqërisë .

Në ballinën e faqes ëeb të Bashkisë Shkodër, në:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/relacion_p_vendimk_f_vllaznia_nr_15147_3363_ok_3432.pdf

është informacioni i plotë financiar, i pasqyruar në pasqyrat financiare të viteve, pjesë e relacionit të miratuar me Vendim nr.54, datë 27.11.2020 “Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të Futbollit “Vllaznia” SH.A. në masën 100%”. Me këtë Vendim Këshilli Bashkiak ka miratuar tjetërsimin e shoqërisë aksionere, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, sipas pasqyrave financiare.

2.7 Persa takon konkluzioneve të përshkruara në germen C7, Ju sqarojmë se:

Të gjitha kriteret e percaktuara në dokumentet standarte të këtij ankandi janë vendosur duke respektuar me përpikmeri detyrimet e percaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të drejtës që i takon Autoritetit Shitës për të bërë përzgjedhjen më të mirë në kualifikimin e atyre subjekteve të cilet krijojnë besueshmeri dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për arritjen e objektivave financiare, sportive dhe publike.

Persa ju argumentuam mesiper në shqyrtimin e kundershtive të shprehura nëpërmjet ankeses së subjektit tuaj, Autoriteti shitës, Bashkia Shkodër e konsideron ankimin tuaj të pa mbështetur në ligj dhe si i tillë nuk mund të pranohet!

Duke ju falenderuar për shprehjen tuaj të interesit!


KRYETAR
Voltana Ademi